

ABSTRAKT

Punimi i paraqitur ka rezultuar nga një hulumtim dhe vështrim i sanksionimit dhe sigurimit të lirive dhe të drejtave të çdo individi në Republikën e Kosovës. Duke studiuar dhe analizuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e deri te ligjet e përgjithshme, janë bërë përpjekje dhe angazhime hulumtuese për të nxjerrë në pah sfidat dhe të arriturat e Republikës së Kosovës në formimin e shtetit dhe të garantimit të drejtave në kushtetutë. Kam punuar dhe hulumtuar në punimin e të drejtave dhe lirive jo vetëm nga ana teorike, duke analizuar rregullativën juridike të Republikës së Kosovës, e në veçanti Kushtetutën dhe mbrojtjen e kushtetutës dhe ligjit, si dhe funksionimin e shtetit të së drejtës gjatë kohës së pandemisë në Kosovë.

Tema e shtjelluar ka si bazë parimet e shkrimit akademik, hulumtimit si dhe përbën një strukturë akademike. Rezultatet e gjetura mbështeten në përgjigjet e pyetjeve kryesore duke u mbështetur poashtu në vërtetimin e hipotezave. Duke implementuar metodologjinë e mbështetur në vrojtimit në praktikë, përshkrimet dhe diskutimet, gjithashtu janë paraqitur dhe komentuar edhe konkluzionet e arritura.

Në bazë të punimit të literaturës, konkludohen pikat e implementimit në praktikë të koncepteve teorike, krahasuar edhe me literaturën bashkëkohore.

Fjalët kyçe: *Shteti I Së Drejtës, Kushtetutshmëria, Ligjshmëria, Të Drejtat, Liritë, Kufizimet, Covid-19, Pandemia, Neni*

